



eimmms



***Rritja e qëndrueshmërisë në nivel lokal
nëpërmjet inovacionit në menaxhimin e
të dhënave***

Bashkia Patos

TABELA E PERMBAJTJES

3-4

Rreth Projektit

5

Metodologjia

6

Konsumi i Energjisë

7

Konsumi i ujit

8

Sasia e Mbetjeve

9-12

Llogaritja e emisioneve
të karbonit

Rreth Projektit

Projekti “Rritja e qëndrueshmërisë në nivel lokal nëpërmjet inovacionit në menaxhimin e të dhënave” është mbështetur financiarisht nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP Albania) në kuadër të projektit “Ngritja e sistemit të menaxhimit mjedisor në Shqipëri dhe sistemit të montorimit në linjë me raportimet globale”. Ky projekt është zbatuar nga Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit dhe ekspertët lokalë.

Ky projekt është zbatuar në Bashkinë e Patosit në bashkëpunim të ngushtë me ekspertet lokalë si Blerina Troka, Majkëll Jajaj të cilët kanë dhënë një kontribut mjaft të vlefshëm në grumbullimin e të dhënave dhe angazhimin përgjatë aktiviteteve. Kohëzgjatja e projektit ka qenë për një periudhë 5 mujore ku gjatë zbatimit të tij kanë asistuar edhe ekspertët ndërkombëtar si Z. Noam Gressel dhe Z. Ziv Weitz. Ekspertë lokalë të angazhuar kanë qenë Z. Oltion Marko dhe Z. Mevis Struga.


Ky projekt ka patur për qëllim ndërtimin e një platforme online ku ti vihej në ndihmë bashkisë për grumbullimin e të dhënave, monitorimin vjetor të tyre si konsumi vjetor i ujit (vetëm për ndërtesat publike), konsumi i energjisë elektrike (vetëm për ndërtesat publike) dhe lëndet djegëse (nafte, dru), sasia e prodhuar e mbetjeve (nga i gjithë territori), transportit publike, etc. Ndërtimi i një databaze të tillë i ndihmon bashkisë të monitorjë në kohë të vazhdueshme performancën e bashkisë për sa i përket konsumit të treguesve si ujë, energji, lëndë djegëse.

Qëllimi tjetër i platformës është llogaritja sipas një metodologjie të përcaktuar emisionet e karbonit për çdo sektor (konsumi i energjisë, ujit, mbetjeve, etc) dhe për ta orjentuar bashkinë në investime konkrete e cila ka për qëllim efencën e energjisë, përdorimin e energjive të rinovueshme, ndërgjegjësimin qytetar.

Metodologjia

Projekti ka konsistuar në një numër aktiviteteve ku çdo aktivitet është realizuar sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar. Pikënisja e projektit ka filluar me realizimin e një takimi me Kryetaren e Bashkisë Patos, Zj. Rajmonda Balilaj ku është diskutuar mbi qëllimin e projektit, aktivitetet dhe rezultatet finale.

Faza 1 (parë) e projektit ka konsistuar në grumbullimin e të dhënave sipas një metodologjie të përcaktuar duke i ndarë objektet sipas tre kategorive: Kategoria e parë ku përfshihen grumbullimi i të dhënave për lëndet djegëse (naftë, dru) për qëllim ngrohje të ndërtesave apo transport kur është rasti të cilat kanë një ndikim direkt në krijimin e emisioneve. Është për tu theksuar se fokus i projektit janë të gjitha objektet publike të menaxhuara nga Bashkia si kopshte, cerdhe, ndricimi publik, teatër, qendra sociale etc. Formuari i ndërtuar nga ekspertët e projektit ju është dërguar pikave të kontaktit në bashki të cilat kanë kontaktuar me departamentet përkatës sipas llojit të informacionit.



Metodologjia

Faze e dytë e aktivitete ka konsistuar në realizimin e takimeve me përfaqësues të bashkisë Patos mbi cilësinë e të dhënave të siguruar dhe hapja e llogarive në platformë për çdo ekspertet e bashkisë të cilët do angazhohen direkt në menaxhimin e platformës. Gjatë takimit në bashkinë Patos ju shpjegua në detaje mënyra sesi do të hidhen të dhënat dhe monitorimi i tyre.

Në fazën e tretë u realizua përpundimi i të dhënave në platformë bazuar në protokollet e inventarëve të gazeve serre dhe faktorëve të emisionit relevant për Shqipërinë. Kjo metodologjie bazohet në llogaritjen e emisioneve sipas tre kategorive I, II dhe III. Mbas përgatitjes së raportit, rezultatet e nxjerra do ti prezantohen përfaqësuesve të Bashkisë.






Figura 1. Takime në Bashkinë Patos

Konsumi i Energjisë


Bazuar në metodologjinë e ndjekur, konsumi i energjisë elektrike kategorizohet në Kategorinë I dhe energjia elektrike në kategorinë II. Objektet të cilat janë marrë për konsumet e energjisë janë objektet publike si shkolla, cerdhe, ndricimi publik. Konsumi i energjisë elektrike vjen në ulje ku në vitin 2020 konsumi i **energjisë elektrike** është 198799 kwh/vit. Ndërsa konsumi i naftës varjon sipas viteve ku në vitin 2020 konsumi i naftës numëron rreth 2700 litër/vit. Vlen për tu përmendur që vetëm këto të dhëna u mundën të grumbullohen nga konsumi i naftës.



Konsumi i Ujit


Konsumi i ujit është një tregues i cili është analizuar nga ndërtesa publike si kopshte, shkollat, bashkia, drejtoria e policisë, qendra rinore dhe banjot publike. Këto të dhëna janë siguruar përgjatë tre viteve (2018, 2019 dhe 2020). Përgjatë vitit 2018 konsumi i ujit është në vlerën 24019 m³, në vitin 2019 shikohet një rritje në vlerën 25210 m³ dhe përgjatë vitit 2020 konsumi i ujit shkon në vlerën 28891m³. Nga grafiku shikohet që përgjatë vitit 2020 është vlera më e lartë e konsumit të ujit me një vlerë rreth 28891 m³ ujë.

Institucionet publike të cilat kanë raportuar për konsumin e ujit janë: kopshtet, cerdhet, bashkia, drejtoria e policies, spitali, drejtoria arsimore, qendrat shëndetësore, spitali, dega e thesarit, zyra vendore e pasurisë, agjencia e punëve publike, pyjorja, zyra e punës, shërbimi zjarrfikës.



Sasia e mbetjeve


Sasia e mbetjeve është një tregues i cili ndryshe nga treguesit e tjerë është analizuar nga gjithë territori i bashkisë si sektori rezidencial, urban, tregtar. Këto të dhëna janë siguruar përgjatë tre viteve (2018, 2019 dhe 2020). Burimi i informacionit për sasinë e mbetjeve është marrë nga INSTAT. Përgjatë vitit 2018 sasia e mbetjeve të gjeneruara është në vlerën 6586 ton, në vitin 2019 shikohet një rritje në vlerën 6670 ton dhe përgjatë vitit 2020 sasia e mbetjeve të gjeneruara shkon në vlerën 6572ton. Nga grafiku shikohet që përgjatë vitit 2019 është vlera më e lartë e sasisë së mbetjeve dhe në vitin 2020 një vlera me e ulët.



Aktualisht mbetjet e grumbulluara nga Bashkia e Patosit e kanë destinacionin në inceneratorin e Fierit ku do të asgjësohen. Sasia e mbetjeve që gjenerohen në Patos janë në përqindjen më të lartë mbetje organike duke marrë parasysh edhe mbizotërimin e zhvillimit bujqësor, shoqëruar me mbetje plastike, letër dhe tekstile. Hedhja e të dhënave në platformë dhe monitorimi i tyre për cdo ditë, muaj dhe vit është më një instrument tepër më rëndësi për Bashkinë e Patosit.

Emisionet e karbonit

Për realizimin e emisioneve të karbonit është ndjekur metodologjia e inventarëve për gazet serrë ndarë në tre kategori: Kategoria 1 ku përfshihet kalkulimi i emisioneve nga aktivitetet që përdorin lëndën djegëse si naftë, dru për ngrohje, transport. Në kategorinë II përfshihet emisionet indirekte nga konsumi i energjisë elektrike nga rrjeti kombëtar dhe kategorinë e III përfshihet nga aktivitete të tjera si mbetjet, konsumi i ujit (energji elektrike), etc. Më poshtë janë vlerat totale të emisioneve për të tre vitet së bashku.



Kategoria I: Emisionet direkte
Lëndët Djegëse

12.29 ton CO₂e

Kategoria II: Emisionet Indirekte
Elektriciteti


7.3 ton CO₂e

Kategoria 3: Emisione burime të tjera
(mbetje, konsumi i ujit)

11756 ton CO₂e


Emisionet e karbonit: Kategoria 1

Për realizimin e emisioneve të karbonit është ndjekur metodologjia e inventarëve për gazet serrë ndarë në tre kategori. Në kategorinë e parë janë mbledhur të dhënat saktësisht konsumin e lëndëve djegëse si naftë. Konsumi i naftës në vitin 2018 ka qenë rreth 200 litër, në vitin 2019 ka qenë 1590 litër dhe në vitin 2020 në vlerën 2700 litër. Të dhënat janë mundësuar të merren vetëm për shkollat "Hekuran Maneku", "Zhani Ciko", "Meleq Gosnishti". Nga të dhënat e siguruara janë gjeneruar vlerat e karbonit përkatësisht për cdo vit. Në vitin 2018 vlera është rreth 0.5 ton, në vitin 2019 rreth 4.4 ton dhe në vitin 2020 ka një rritje në vlerën 7.4 ton CO₂.




Emisionet e karbonit: Kategoria 2

Për realizimin e emisioneve të karbonit është ndjekur metodologjia e inventarëve për gazet serrë ndarë në tre kategori: Kategoria 2 ku përfshihet kalkulimi i emisioneve (indirekte) nga aktivitetet që konsumojnë energjinë elektrike. Objektet që janë marrë në konsideratë për prodhimin e energjisë elektrike janë kopshtet, ndërtesa e bashkisë, ndricimi publik, qendrat sociale, shkollat 9 vjecare, fillore dhe të mesme, ndërtesat e bashkisë. Sasia e karbonit e emetuar në vitin 2018 është përlogaritur në vlerën 2.9 ton CO₂, në vitin 2019 është 2.4 ton CO₂ dhe në vitin 2020 është në vlerën 2 ton. Shikohet që përgjatë vitit 2020 ka një zvogëlim të sasisë së karbonit të emetuar.




Emisionet e karbonit: Kategoria 3

Në kategorinë e tretë përfshihen aktivitetet si sasia e mbetjeve të gjeneruara, energjia elektrike që vjen nga konsumi i ujit, transporti publik dhe ujrat e ndotur. Një vecori me rëndësi për tu theksuar është se sasia e mbetjeve të prodhuara është marrë për të gjithë territorin duke përfshirë edhe sektorin rezidencial, tregtar, industrial etc. Ndërsa treguesit e tjerë janë vetëm për objektet publike. Emetimet e karboni nga sasia e mbetjeve janë goxha të lartë dhe ka një trend ulës. Për tu theksuar janë emisionet nga transporti publik, uji i pijshëm që janë në trend ulës dhe ato nga ujrat e ndotur që gjithashtu janë në një nivel të njëjtë përgjatë tre viteve.



Përfundime



Kategoria I: Emisionet direkte
Lëndët Djegëse

12.29 ton CO2e

Kategoria II: Emisionet Indirekte
Elektriciteti

7.3 ton CO2e

Kategoria 3: Emisione burime të tjera
(mbetje, konsumi ujit)

11756 ton CO2e